



Pranuar / Dorezuar Priljeho/Prodato Received/Delivaty	29.05	2023	3	viti god year
Organ/Njësia Organ/Jedinica Org./Unit	Nr Prot Br Prot Prot No	Shtojca Prilog Appendix	Sasia Kolicina Quantity	
SRMISHCK	4505/2023		115	



Republika e Kosovës
Republika Kosova-Republic of Kosovo

KËSHILLI I PAVARUR MBIKËQYRËS PËR SHËRBIMIN CIVIL TË KOSOVËS
NEZAVISNI NADZORNI ODBOR CIVILNE SLUŽBE KOSOVA
INDEPENDENT OVERSIGHT BOARD FOR THE CIVIL SERVICE OF KOSOVA

A.nr.640/2023

Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës-Kolegji për Shqyrtimin dhe Vendosjen e Ankesave në përbërje nga: Eshref Shabani-Kryetar, Arben Mehmeti dhe Ardita Haxhnikaj Demi-anëtarë, me Rushit Kajtazi -Zyrtar i Lartë për Bashkëpunim Profesional, në cilësinë e procesmbajtësit, ka shqyrtuar ankesën me numër A.nr.582/2023 të datës 29.03.2023 të parashtruar nga ankuesja Rukije Matoshi grup ankuesish dhe ankesën me numër A.nr.640/2023 të datës 14.04.2023 të parashtruar nga ankuesja grup ankuesish përmes përfaqësueses të autorizuar Avokates kundër organit të punësimit, Sekretariati i Këshillit Gjyqësor të Kosovës, të bashkuar përmes Vendimit me numër protokollit 4223/2023 të datës 12.05.2023 të Kryetarit të Këshillit të Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës në ankesë me numër A.nr.640/2023, në çështjen juridike "Kompensim Material", duke vepruar në pajtim me nenin 6 paragrafin 1 nën paragrafin 1.1 dhe nenin 18 paragrafin 1 nën paragrafin 1.5 të Ligjit Nr. 06/L-048 për Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës dhe Rregulloren Nr. 02/2018 për Procedurën e Shqyrtimit dhe Vendosjes së Ankesave në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, në seancën për këshillim dhe votim, me datën 29.05.2023, mori këtë:

V E N D I M

Përfundon Procedimi Administrativ i iniciuar sipas ankesës me numër A.nr.582/2023 të datës 29.03.2023 të parashtruar nga ankuesja grup ankuesish dhe ankesa me numër A.nr.640/2023 të datës 14.04.2023 të parashtruar nga ankuesja grup ankuesish të bashkuar në ankesën me numër A.nr.640/2023.

A r s y e t i m

Ankuesja e punësuar në pozitën "Sekretare Juridike" në Gjykatën Themelore në Prishtinë dega në Lipjan sipas Akt Emërimit të datës 28.12.2012, ankuesja e punësuar në pozitën "Sekretare Juridike" në Gjykatën Themelore në Prishtinë dega në Lipjan sipas Akt Emërimit të datës 28.12.2012, ankuesja e punësuar në pozitën "Sekretare Juridike" në Gjykatën Themelore në Prishtinë dega në Lipjan sipas Akt

Emërimit të datës 28.12.2012, ankuesja [redacted] e punësuar në pozitën "Arkatare" në Gjykatën Themelore në Prishtinë dega në Lipjan sipas Akt Emërimit të datës 28.12.2012, ankuesja [redacted] e punësuar në pozitën "Zyrtare Ligjore" në Gjykatën Themelore në Prishtinë dega në Lipjan sipas Akt Emërimit të datës 25.07.2017, ankuesja [redacted] e punësuar në pozitën "Zyrtare Ligjore" në Gjykatën Themelore në Prishtinë dega në Lipjan sipas Akt Emërimit të datës 25.07.2017, ankuesja [redacted] e punësuar në pozitën "Sekretare Juridike" në Gjykatën Themelore në Prishtinë dega në Lipjan sipas Akt Emërimit të datës 28.12.2012, dhe ankuesja [redacted] e punësuar në pozitën "Arkatare" në Gjykatën Themelore në Prishtinë dega në Lipjan sipas Akt Emërimit të datës 28.12.2012, përmes përfaqësueses së autorizuar kanë parashtruar ankesë përmes postës me datë 24.03.2023 e cila është pranuar me numër protokolli 3090/2023 me datë 29.03.2023, në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, me pretendimin ankimor lidhur me kompensimin e shpërblimit jubilar për ankuesit, me rastin e arritjes së përvojës së punës në shërbimin civil.

Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës bazuar në dispozitat e Ligjit Nr. 06/L-048 për Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës dhe Rregullores Nr. 02/2018 për Procedurën e Shqyrtimit dhe Vendosijes së Ankesave në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, më datë 03.04.2023 me numër protokolli 3268/2023 ka dërguar kërkesën për përgjigje në ankesë tek Sekretariati i Këshillit Gjyqësor të Kosovës, ndërsa Këshilli më datë 12.05.2023, ka pranuar përgjigje në ankesë nga Sekretariati i Këshillit Gjyqësor të Kosovës, me shkresat e bashkangjitura.

Ankuesja [redacted]

dhe [redacted] të gjithë të punësuar në Gjykatën Themelore në Prishtinë dega në Lipjan, përmes përfaqësueses së autorizuar kanë parashtruar ankesë përmes postës me datë 12.04.2023 e cila është pranuar me numër protokolli 3563/2023 me datë 14.04.2023, në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, me pretendimin ankimor kundër vendimit të Komisionit për Zgjidhjen e Kontesteve dhe Ankesave të Sekretariatit të Këshillit Gjyqësor të Kosovës me numër KA.nr.08/2023.

Kryetari i Këshillit të Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, më datë 12.05.2023 ka nxjerr Vendim me numër protokoll 4223/2023 përmes të cilit ka bërë bashkimin e ankesës me numër A.nr.582/2023 të datës 29.03.2023 të parashtruar nga ankuesja [redacted] grup ankuesish dhe ankesës me numër A.nr.640/2023 të datës 14.04.2023 të parashtruar nga [redacted] grup ankuesish për shkak që faktet dhe baza ligjore për vendimmarrje është e njëjtë.

Kolegji për shqyrtimin dhe vendosjen e ankesave ka administruar këto prova: Ankesën me nr.protokolli 3563/2023 të datës 14.04.2023 e parashtruar nga grup ankuesish përmes përfaqësueses së autorizuar avokates M.G. në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës; Kërkesë për kompensimin e shpërblimit jubilar drejtuar Sekretariati i Këshillit Gjyqësor të Kosovës nga përfaqësuesja e autorizuar i datës 11.01.2023; Kërkesë për kompensimin e shpërblimit jubilar drejtuar Komisionit për Zgjidhjen e Kontesteve dhe Ankesave në Sekretariatit të Këshillit Gjyqësor të Kosovës nga përfaqësuesja e autorizuar i datës

27.02.2023; E-mail nga M.G. për ankesa.kpmschck@rks-gov.net i datës 15.04.2023; Autorizim nga N.A. për M.G. i datës 23.06.2021; Autorizim nga SH.S.M. për M.G. i datës 10.09.2021; Autorizim nga H.T. për M.G. i datës 07.07.2021; Autorizim nga M.D. për M.G. i datës 07.07.2021; Autorizim nga H.I. për M.G. i datës 16.07.2021; Autorizim nga M.Zh. për M.G. i datës 07.07.2021; Autorizim nga R.M. për M.G. i datës 16.07.2021; Autorizim nga E.T. për M.G. i datës 07.07.2021; Dëftesë për pranimin e dërgesës e datës 27.02.2023; Kërkesë për kompensimin e shpërblimit jubilar drejtuar KPMSHCK i datës 24.03.2023; Dëftesë për pranimin e dërgesës e datës 24.03.2023; Vendim i Komisionit për Zgjidhjen e Kontesteve dhe Ankesave në Sekretariatit e Këshillit Gjyqësor të Kosovës me numër KA.nr.08/2023 i datës 03.04.2023; Pliko me numër R2922141 i datës 12.04.2023; Vendim për bashkimin e lëndëve me numër protokollit 4223/2023 i datës 12.05.2023; Ankesën me nr.protokollit 3090/2023 të datës 29.03.2023 e parashtruar nga grup ankuesish përmes përfaqësueses së autorizuar avokates M.G. në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës; Pliko me numër R2921437 i datës 24.03.2023; Kërkesë për përgjigje në ankesë me numër protokollit 3268/2023 i datës 03.04.2023; Përgjigje në ankesë e datës 12.05.2023; Kërkesë për kompensimin e shpërblimit jubilar drejtuar Komisionit për Zgjidhjen e Kontesteve dhe Ankesave në Sekretariatit e Këshillit Gjyqësor të Kosovës nga përfaqësuesja e autorizuar i datës 02.03.2023; Vendim i Këshillit të Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës me numër protokollit 8054/2022 i datës 14.12.2022; Fletëdërgesë për dorëzim personal e datës 05.04.2023; Fletëdërgesë për dorëzim personal e datës 05.04.2023; Fletëdërgesë për dorëzim personal e datës 05.04.2023; Fletëdërgesë për dorëzim personal e datës 05.04.2023; Fletëdërgesë për dorëzim personal e datës 05.04.2023; Fletëdërgesë për dorëzim personal e datës 05.04.2023; Fletëdërgesë për dorëzim personal e datës 05.04.2023; Fletëdërgesë për dorëzim personal e datës 05.04.2023; Fletëdërgesë për dorëzim personal e datës 05.04.2023; Akt Emërim i E.T. i datës 25.07.2017; Akt Emërim i R.M. i datës 28.12.2012; Akt Emërim i M.Zh. i datës 28.12.2012; Akt Emërim i M.D. i datës 28.12.2012; Akt Emërim i Sh.S. i datës 28.12.2012; Akt Emërim i N.A. i datës 28.12.2012; Akt Emërim i H.T. i datës 25.07.2017; Lista e pagave prej datës 01.12.2013 deri 31.12.2013; Lista e pagave prej datës 01.12.2013 deri 31.12.2013; Lista e pagave prej datës 01.12.2013 deri 31.12.2013; E-mail nga F.K. për C.Z. i datës 23.05.2023; Akt Emërim i H.I. i datës 28.12.2012;

Kolegji për shqyrtimin dhe vendosjen e ankesave pasi ka shqyrtuar dhe analizuar të gjitha shkresat e lëndës të parashtruara nga palët në procedurë, konstatoi që të përfundoi procedimi administrativ i iniciuar sipas ankesës me numër A.nr.640/2023 i datës 14.04.2023 të parashtruar nga ankuesja grup ankuesish, *sepse:*

Ankuesit përmes përfaqësueses së autorizuar kanë parashtruar kërkesë me numër Nr.01/341 me datë 02.03.2023 për kompensimin e shpërblimit jubilar drejtuar Komisionit për Zgjidhjen e Kontesteve dhe Ankesave në Sekretariatit e Këshillit Gjyqësor të Kosovës. Komisioni për Zgjidhjen e Kontesteve dhe Ankesave të Sekretariatit të Këshillit Gjyqësor të Kosovës ka nxjerrë vendim me numër KA.nr.08/2023 me datë 03.04.2023 përmes të cilit ka hedhë poshtë si të pasafatshme kërkesën me numër Nr.01/341 të datës 02.03.2023 lidhur me kompensimin e shpërblimit jubilar për ankuesit, me rastin e arritjes së përvojës së punës në shërbimin civil.

Bazuar në shkresat e lëndës Kolegji ka gjetur se ankuesit

dhe të gjithë janë të punësuar në Gjykatën Themelore në Prishtinë dega në Lipjan, të njëjtit përmes përfaqësueses së autorizuar kanë parashtruar ankesë në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës me pretendimet ankimore lidhur me kompensimin e shpërblimit jubilar për ankuesit, me rastin e arritjes së përvojës së punës në shërbimin civil si dhe kundër vendimit të Komisionit për Zgjidhjen e Kontesteve dhe Ankesave të Sekretariatit të Këshillit Gjyqësor të Kosovës me numër KA.nr.08/2023.

Kolegji i Këshillit, gjatë shqyrtimit të ankesës së ankuesve ka konstatuar se lidhur me pretendimet ankimore të ankuesve për të njëjtën çështje lidhur me kompensimin e shpërblimit jubilar për ankuesit, me rastin e arritjes së përvojës së punës në shërbimin civil për të njëjtën çështje Këshilli ka vendosur në mënyrë meritore sipas vendimit me numër protokollit 8054/2022 me datë 15.12.2022.

Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës me datë 08.09.2021 ka pranuar ankesën nga grup ankuesish përmes përfaqësueses së autorizuar avokates me numër protokollit 4540/2021 të regjistruar në shenjë A.nr.788/2021 në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës me pretendimet ankimore për kompensimin e pagës jubilarë për 20 vite në shërbim civil. Ndërsa Këshilli me Vendimin me numër A.nr.788/2021 të datës 14.12.2022 me numër protokollit 8054/2022 ka shqyrtuar ankesën e grup ankuesish dhe për të njëjtën ka vendosur meritorisht.

Bazuar në këtë Kolegji konstaton se meqenëse Këshilli brenda periudhës dy vjeçare ka vendosur për ankesën e grup ankuesish për çështjen lidhur me kompensimin e shpërblimit jubilar për ankuesit, me rastin e arritjes së përvojës së punës në shërbimin civil sipas vendimit me numër A.nr.788/2021 të datës 14.12.2022 me numër protokollit 8054/2022, atëherë ankesa e grup ankuesish rrjedhimisht është e konsumuar pasi që Këshilli ka vendos sipas Vendimit me numër A.nr.788/2021 të datës 14.12.2022 me numër protokollit 8054/2022, atëherë Kolegji konstaton se janë përmbushur kushtet ligjore për përfundimin e procedimit administrativ të iniciuar sipas ankesës së ankuesve komfor dispozitave të nenit 101 paragrafit 1 nën paragrafit 1.1 të Ligjit Nr. 05/L-031 për Procedurën e Përgjithshme Administrative, i cili përcakton se: *1. Një organ publik përfundon një procedurë administrative, në cilëndo fazë të saj, nëse zbulon se: 1.1. gjatë më pak se dy (2) viteve para datës së parashtrimit të kërkesës, ka vendosur për të njëjtën kërkesë të paraqitur nga pala e njëjtë, me të njëjtin qëllim dhe bazuar mbi të njëjtën situatë faktike*". Kolegji konstatoi që të përfundoj procedimi administrativ i filluar me ankesën A.nr.640/2023 të datës 14.04.2023 të parashtruar nga grup ankuesish.

Kolegji për shqyrtimin dhe vendosjen e ankesave, pas analizimit dhe vlerësimit të gjitha shkresave të lëndës si dhe duke u bazuar në kompetencën e Këshillit dhe sipas nenit 101 paragrafit 1 nën paragrafi 1.1 të Ligjit Nr. 05/L-031 për Procedurën e Përgjithshme Administrative dhe nenit 18 paragrafit 1 nën paragrafit 1.5 të Ligjit Nr. 06/L-048 për Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, vendosi si në dispozitiv të këtij Vendimi.

Vendimi hyn në fuqi në ditën e nënshkrimit nga Kryetari i Kolegjit.

Këshillë juridike: Kundër vendimit të Këshillit, pala e pakënaqur e cila pretendon se vendimi i Këshillit nuk është i ligjshëm mund të iniciojë konflikt administrativ në gjykatën kompetente, Gjykatën Themelore në Prishtinë/Departamenti për Çështje Administrative brenda afatit prej tridhjetë (30) ditësh nga dita në të cilën i është dorëzuar vendimi. Inicimi i konfliktit administrativ nuk e ndalon ekzekutimin e këtij vendimi.

KËSHILLI I PAVARUR MBIKËQYRËS PËR SHËRBIMIN CIVIL TË KOSOVËS
Lënda me numër A.nr.640/2023


Ruslita Kajtazi
Procesmbajtës



Vendimi i dërgohet:

- Përfaqësuesit të autorizuar të ankuesve avokates
- Drejtorit të Përgjithshëm në Sekretariatit e Këshillit Gjyqësor të Kosovës;
- Udhëheqësit të Personelit në Sekretariatit e Këshillit Gjyqësor të Kosovës; dhe
- Arkivit të KPMSHCK-së.

